

AKT – THEMELIMI
i
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

PAMLEIT energy

Në Durrës, më 04 Totor 2024,

Unë, **Valentina Sokolaj**,

e birja e Shyqyri-ut, e datëlindjes 04.08.1958, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal F85804042T, me shtetasi shqiptare, madhere e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur në Tiranë dhe banuese në Durrës, në adresën: Rruga RAMAZAN JELLA, Ndërtesa nr. 67, Hyrja 22, Apartamenti 58, Durës.

bazuar në aktet ligjore:

Liqji nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Liqji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;

Liqji nr. 9723, datë 03.05.2007 „Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“

vendosa themelimin e shoqërisë tregtare në vijim:

Neni 1

EMRI SHOQËRISË

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike me : Emri Shoqërisë është **PAMLEIT energy**

Neni 2

FORMA JURIDIKE

Shoqëria **PAMLEIT energy** është e formës juridike Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 3

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit të saj.

Neni 4

SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:

Durrës, Shkallnur, Zona Kadastrale nr. 3385, Njësia me numër pasurie 578/321/nd-n1, Rezidenca Banimit nr.2 Shkallnur.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjenci, përfaqësi, seli sekondare si dhe t'i suprimojë ato.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
sokolajenergy@gmail.com

Valentina Sokolaj
(Handwriting)

Neni 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa kufizim.

Neni 6
KAPITALI THEMELTAR FILLESTAR I SHOQËRISË

2

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerën lekë 2,300,000 (dymilion e treqindmijë) që përbën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e ortakëve:

Ortaku vetëm Valentina Sokolaj është pjesmarës në zotërimin e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithëshme në lekë All 100,000 (njëqindmijë) që përbën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në lekë Al.

Neni 7

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare, do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakët. Rritja e kapitalit të ortakëve nuk është e kufizuar.

Neni 8

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësish të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 9
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 10
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

Valentina Sokolaj
Ortak

- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 11

OBJEKTI VEPRIMTARISË

3

- Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk) do ta ushtrojë veprimtarinë sipas objektit:
- Studimi dhe projektim i objekteve civile, industriale, turistike, bujqësore etj. studim fizibiliteti, studime urbanistike e tjera të kësaj natyre.
Restaurimi i godinave dhe objekteve te ndryshme civile, industriale dhe veshje fasade. Punime dhei e transport, punime murature, me materiale të ndryshme betoni, beton armeje, ndërtim parafabrikat, konstruksione të ndryshme metalike e druri.
 - Rikonstruksioni objekteve civile dhe industriale, ujësjellës kanalizime, rrugë, vepra arti, restaurim i objekteve te monumenteve te kultures, si dhe punime guri te te gjitha llojeve. Prodhim e tregëtim të materialeve të ndërtimit me shumicë e pakicë, import-eksport si dhe prodhime inertesh etj. Përdorimi i mjeteve të mekanizuara.
Zbatimi i projekteve në punë publike si shërbime pastrimi, gjelbërimi dhe mirmbjtje e sipërfaqeve të gjelberuara.
 - Prodhimi energjise elektrike duke shfrytezuar burimet e energjise te cilat gjenden ne natyre dhe janë te rinovueshme. Projektimi dhe Zbatimi, Studimi i Termo Centraleve apo/dhe Impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe janë te rinovueshme, si dhe i Nenstacioneve e Linjave te Transmetimit TU & TL.
 - Ndertimi, Projekti, Menaxhimi, Mirembajtje dhe Operimi ne fushen e Termocentraleve apo/dhe Impianteve te cilat shfrytezojne energjinee rinovueshme.
 - Shitia e energjise elektrike klienteve apo / dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit.
 - Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjekcionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike.
 - Operator i sistemit te transmetimit per te kryer aktivitetin e transmetimit te energjise elektrike dhe te dispegerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike sipas kerkesave te konsumit, ne nivel kombetar).
 - Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike dhe marra nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e ketij aktiviteti tregtar ne menyre te qete dhe në perputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqiperise. Shoqeria ka te drejtë te ushtrojë çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji në perputhje me rregullat e dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse te lëshuara nga organet kompetente te fushes.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Valentina Sokolić". The signature is fluid and cursive, with "Valentina" at the top and "Sokolić" below it, though the spelling "Sokolić" is more standard.

- Ndërmjetësim tregëtar, lidhje kontrata të të gjitha llojeve për llogari dhe në emër të personave të tretë dhe çdo veprimtari tjeter që nuk është e ndaluar nga legjislacioni shqiptar.
- Ndërtimin e rrjetit të infrastrukturës, brenda e jashtë sheshit të ndërtimit, si: furnizimi me energji elektrike, telefoni, ujësjellës, kanalizime, sistemime, rrugë e sheshe, si dhe rrrethimin e përhershëm.
- Ndërtimi linjave të jashtme ajrore dhe nëntokësore, elektrike, të telefonisë, radiofonisë, të televizionit, përfshirë përcjellësit, izolatorët, shtyllat dhe punimet e tjera të ndërtimit.
- Ndërtimi hidrocentraleve, termocentraleve, nënstacioneve, kabinave elektrike, përfshirë ndërtimet dhe rrjetin e infrastrukturës, brenda dhe jashtë sheshit të ndërtimit.
- Tregti me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme import - eksport i tyre. Importim-eksportim, tregtim me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, pajisje hidrosanitare, kompjuterike, industriale, pajisje duralumini etj.

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 12

ORGANI VENDIMMARRES

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 13

ADMINISTRIMI

5

Asambleja e përgjithshme emëron administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 - vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Asambleja përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Asambleja e Përgjithshme emëron Administratore të shoqërisë Valentina Sokolaj e datëlindjes 04.08.1958, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lindur në Tiranë dhe banuese në Durrës, në adresën: Rruga RAMAZAN JELLA, Ndërtesa nr. 67, Hyrja 22, Apartamenti 58, Durës, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga 04.10.2024 deri 03.10.2029 me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 14

LIBRAT DHE REGJISTRAT

Shoqëria do të mbajë dhe do të ruajë sipas afateve ligjore librat dhe regjistrat e saj, do të mbajë procesverbalet e mbledhjeve sipas formës dhe përbajtjes përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 15

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

*Valentina Sokolaj
C. 2024*

- Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblenë e Përgjitheshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.

Vakthije Shkodra
Lekëdhi

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

7

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbllimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17

VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 18

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

*Vjosa Shkodra
Asoci*

Neni 19

RIORGANIZMI I SHOQËRISË, BASHKIMI, NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Bashkimi shoqërisë me një apo disa shoqëri të tjera, nuk mund të bëhet pa miratimin paraprak me Vendimi të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve zotërues të 100 % të kutave të kapitalit të shoqërisë.

Neni 20

TË PËRGJITHSHME

Ky Akt - Themelimi ka 20 dispozita, u hartua në gjuhën shqipe në ekzemplarë të njëjtë, miratohet e nënëshkruhet me vullnetin e lirë nga :

ORTAKU THEMELUES
të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

PAMLEIT energy

Emër, mbiemër e nënshkrimi

*Vokontree Sato¹
Cukalës*